



BASHKIA  
TIRANË

**Drejtuar:** Bashkimit të Operatorëve ekonomik “Rrugë Sinjalistike Mirëmbajtje dhe Hidro Company” Degë e shoqërisë së huaj & “Egland” shpk

**Adresa:** Tiranë, Njësia Nr. 8, Rruga “Xhorxhi Martini”, Nr. 2, godinë Nr. 11-katëshe, Shkalla 2, kati 7.

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Procedura e prokurimit:** “Procedurë e Hapur” “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Ded Gjon Luli” – Blv. “Zogu i Parë” – “Mine Peza” dhe rikonstruksion i Rr. “Prokop Myzeqari” dhe Rr. “Hamid Shijaku”

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** Qëllimi i kontratës është: “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Ded Gjon Luli” – Blv. “Zogu i Parë” – “Mine Peza” dhe rikonstruksion i Rr. “Prokop Myzeqari” dhe Rr. “Hamid Shijaku”.

**Numri i referencës së procedurës/lotit:** Ref-77834-07-04-2018

**Fondi limit:** 106,057,531 (njëqind e gjashtë milion e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tridhjetë e një) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:** vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2018, miratuar me VKB Nr. 47 datë 26.04.2018 “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës Nr. 132, datë 21.12.2017, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2018 – 2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018 (i ndryshuar)”.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 8 (tetë) muaj kalendarike kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit:** 13.08.2018, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 27 datë 09.07.2018.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Rrugë Sinjalistike Mirëmbajtje dhe Hidro Company” dshh & “Egland” shpk**

**NUIS L04803001U & NUIS**

**J96829419D**

Vlera e ofertës = **72,119,145** (shtatëdhjetë e dy milion e njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e njëqind e dyzetë e pesë) lekë pa TVSH.

**2. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Shendelli” shpk & “Glavenica” shpk**

**NUIS K07924803N & NUIS K17710805A**

Vlera e ofertës = **73,378,782** (shtatëdhjetë e tre milion e treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

**3. Operatori ekonomik “Bami” shpk**

**NUIS J94416206R**

Vlera e ofertës = **74,234,140** (shtatëdhjetë e katër milion e dyqind e tridhjetë e katër mijë e njëqind e dyzetë) lekë pa TVSH.

**4. Bashkimi i Operatoreve ekonomik “Mela.” shpk & “Alb Shpresa” shpk**

**NUIS K62320011G & NUIS J72110003F**

Vlera e ofertës = **79,000,000** (shtatëdhjetë e nëntë milion) lekë pa TVSH.

**5. Bashkimi i Operatoreve ekonomik “Liqeni VII” sha & “Varaku E” shpk**

**NUIS K01730502W & NUIS J61902509S**

Vlera e ofertës = **79,132,438** (shtatëdhjetë e nëntë milion e njëqind e tridhjetë e dy mijë e katërqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

**6. Bashkimi i Operatoreve ekonomik “Bean” shpk & “Erges Mat” shpk**

**NUIS J72510445Q & NUIS K17614913O**

Vlera e ofertës = **80,126,775** (tetëdhjetë milion e njëqind e njëzetë e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

**7. Operatori ekonomik “Curri” shpk** **NUIS J67902718S**

Vlera e ofertës = **81,276,229** (tetëdhjetë e një milion e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e njëzetë e nëntë) lekë pa TVSH.

**8. Operatori ekonomik “Arifaj” shpk**

**NUIS J76418907K**

Vlera e ofertës = **91,459,923** (nëntëdhjetë e një milion e katërqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzetë e tre) lekë pa TVSH.

**9. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “AGB 3” shpk & “Senka” shpk**  
NUIS L22321003R & NUIS J94808405Q

Vlera e ofertës = **92,788,168** (nëntëdhjetë e dy milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

**1. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Shendelli” shpk & “Glavenica” shpk**

NUIS K07924803N & NUIS K17710805A

• Referuar përqindjes së partneritetit shoqëria “Glavenica” shpk ka deklaruar se ka të punësuar pranë shoqërisë 1 (një) punonjës teknik ndërtimi (L.B). Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se për punonjësën e sipërcituar shoqëria “Glavenica” shpk nuk ka paraqitur Dëshminë e Kualifikimit. Për sa më lart, Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7, ku përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë:*

- 2 (dy) punonjës teknik ndërtimi
- 3 (tre) punonjës hidraulik
- 1 (një) punonjës karpentir
- 2 (dy) punonjës elektrikistë
- 2 (dy) punonjës saldatorë
- 2 (dy) punonjës bojaxhinj

*Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; deshmite e kualifikimit te sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe te figurojnë ne listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.”*

- Referuar Shtojcës 10, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Shendelli” shpk & “Glavenica” shpk ka deklaruar se disponon 3 (tre) kamionçina përkatësisht me targa AA 264 OB; AA 959 GS si dhe AA 693 OY. Pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetet e deklaruara si më lart, KVO konstatoi se kamionçina me targë AA 264 OB ka kapacitet mbajtës 0.9 Ton; mjete me targë AA 959 GS ka kapacitet mbajtës 1.2 Ton ndërsa mjete me targë AA 693 OY ka kapacitet mbajtës 1 Ton. Për sa më lart, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Shendelli” shpk & “Glavenica” shpk nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 3 (tre) kamionçina me*

*kapacitet mbajtës 2 – 5 ton”.*

- Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Shendelli” shpk & “Glavenica” shpk ka deklaruar se disponon 2 (dy) Autobetoniere përkatësisht me targa AA 754 AR si dhe AA 403 HE. KVO, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetet e deklaruara si më lart, konstatoi se Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk ka paraqitur Çertifikatë për transport mallrash Brenda vendit, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, gërma “a”.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Shendelli” shpk & “Glavenica” shpk, referuar Shtojcës 10 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

## 2. **Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Bami” shpk** **NUIS** J94416206R

- Operatori ekonomik “Bami” shpk, në formularin e Deklarimit të Ofertës ka paraqitur një ofertë ekonomike të ndryshme nga oferta e paraqitur në Preventiv. Në Formularin e Deklarimit të Ofertës oferta ekonomike pa TVSH është **72,071,981** (shtatëdhjetë e dy milion e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një) lekë ndërsa me TVSH është **89,080,969** (tetëdhjetë e nëntë milion e tetëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë. Në Preventivin e paraqitur nga kjo shoqëri oferta ekonomike pa TVSH është **74,234,140** (shtatëdhjetë e katër milion e dyqind e tridhjetë e katër mijë e njëqind e dyzetë) lekë ndërsa oferta ekonomike me TVSH është **89,080,969** (tetëdhjetë e nëntë milion e tetëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë. Kjo bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu VII, Neni 63 pika 2 në të cilën ndër të tjera përcaktohet se:  
*“Operatorët ekonomik duhet të paraqesin vetëm një ofertë, me përjashtim të rasteve kur kërkohen oferta alternative”.*
- Gjithashtu Shoqëria “Bami” shpk ne vertetimin e paraqitur nga Administrata Tatimore si dhe ne list pagesat e paraqitura per periudhen Qershor 2017 – Qershor 2018, rezulton te kete nje numer mesatar prej **134 punonjesish**.  
Ndërkohë shoqëria “Bami” shpk eshte shpallur fituese prane Autoritetit Kontraktor Bashkia Tirane, per procedurën e prokurimit me objekt: **“Rikonstruksion i trotuarëve dhe rrugës “Hoxha Tahsim” dhe “Xhanfize Keko”** ku numri i punonjesve te kerkuar ka qënë **70 punonjes**. Për sa më lart rezulton se **70** punonjes te kesaj shoqerie janë të angazhuar per realizimin e objektit për të cilin është shpallur fitues. Pra ne diference punonjesish me ata të angazhuar për realizimin e kontrates se lartpermendur, shoqërisë i ngelen vetëm **64** punonjës. Numri mesatar i punonjesve te kerkuar për realizimin e objektit **“Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga**

**rruga “Ded Gjon Luli” – Blv. “Zogu i Parë” – “Mine Peza” dhe rikonstrukcion i Rr. “Prokop Myzeqari” dhe Rr. “Hamid Shijaku”** është 80 punonjes. Në këtë mënyrë shoqëria nuk zotëron kapacitetet e mjaftueshëm teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 4, çka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të Nenit 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” (i ndryshua) ku përcaktohet se:

*Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

*b) Aftësia teknike ; Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, pajset dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.....*

- Shoqëria “Bami” shpk ka deklaruar si drejtues teknik të shoqërisë Ing. Znj. M.Gj të cilën me anë të deklaratës për drejtuesin teknik e ka caktuar tashmë drejtuese teknike për objektin në të cilin është kualifikuar në vend të parë nga Bashkia Tirane: “Rikonstrukcion i trotuarëve dhe rrugës “Hoxha Tahsim” dhe “Xhanfize Keko” dhe për të cilën ka deklaruar se nuk do të jete e angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jete gjatë gjithë kohës në objekt duke mos plotësuar kështu Kriteret e Veçanta për Kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 3, pjesë përbërëse e Dokumentave Standarte të Tenderit.
- Operatori ekonomik “Bami” shpk ka deklaruar pjesë të shoqërisë 2 (dy) Punonjës Teknik ndërtimi e konkretisht punonjësit me iniciale F.Xh dhe A.L. KVO pasi verifikoi dokumentacionin shoqëruar për punonjësit e deklaruar si më lart, konstatoi se punonjësi A.L rezulton të jetë Topograf dhe jo Teknik Ndërtimi, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7 ku përcaktohet se: “*Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si më poshtë:*

  - *2 (dy) punonjës teknik ndërtimi*
  - *3 (tre) punonjës hidraulik*
  - *1 (një) punonjës karpentir*
  - *2 (dy) punonjës elektrikistë*
  - *2 (dy) punonjës saldatorë*
  - *2 (dy) punonjës bojaxhinj*

*Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; deshmite e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.”.*

- Pas verifikimit të dokumentacionit shoqëruar për mjetin “Fadromë”, të deklaruar në Shtojcën 10, u konstatua se është paraqitur vetëm fatura tatimore dhe jo



dokumentacioni i plotë tekniko-ligjor, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, germa a), ku përcaktohet se: “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jone aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore të blerjes.

- Referuar Shtojcës 10, Shoqëria “Bami” shpk ka deklaruar se disponon 3 (tre) kamionçina përkatësisht me targa KR 7049 A; AA 096 GP si dhe AA 053 ND. Pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetet e deklaruara si më lart, KVO konstatoi se kamionçina me targë KR 7049 A ka kapacitet mbajtës 2.5 Ton; mjeti me targë AA 096 GP ka kapacitet mbajtës 0.9 Ton ndërsa mejtja me targë AA 053 ND ka kapacitet mbajtës 0.9 Ton. Për sa më lart, Operatori ekonomik “Bami” shpk nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 3 (tre) kamionçina me kapacitet mbajtës 2 – 5 ton”*.
- KVO, pasi verifikoi Shtojcën 10 konstatoi se mjeti Autobitumatriçe me targë AA 067 UG rezulton të jetë e montuar = Kamionçinë + bitumatriçe, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15 ku përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Autobitumatriçe”*.
- KVO, pasi verifikoi Shtojcën 10 konstatoi se mjeti Autobot uji me targë AA 951 FE rezulton të jetë i montuar = Kamion + Alpozitë uji, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15 ku përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Autobot uji”*.
- Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik “Bami” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobetoniere përkatësisht me targa KR 8702 A. Pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetet e deklaruara si më lart, KVO konstatoi se mjeti është deklaruar në procedurën me objekt: “Rikonstruksion i trotuarëve dhe rrugës “Hoxha Tahsim” dhe “Xhanfize Keko” për të cilën Operatori ekonomik është shpallur fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë. Për sa më lart, Operatori ekonomik “Bami” shpk nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, germa “f”.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, germa “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, germa “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Bami” shpk, referuar Shtojcës 10 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

### 3. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatoreve ekonomik “Mela.” shpk & “Alb Shpresa” shpk

NUIS K62320011G & NUIS J72110003F

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, konstaton se Operatori ekonomik ka deklaruar në Shtojcën 10 mjetin ‘Autobitumatrice Marini’ si dhe mjetin Autobitumatrice të deklaruar si të marrë me qera nëpërmjet kontratës së qerasë Nr. 1052.Rep, Nr. 296.Kol të cilët nga verifikimi i dokumentacionit rezultojnë bitumatrice, paraqitur vetëm me faturë tatimore çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Alb-Shpresa” shpk & ”Mela” shpk nuk përmbushin pikën 15, gërma “b”: *“Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme)”* pasi dokumentacioni për mjetet të deklaruara si Autobitumatrice rezulton pa Çertifikatën për Transport mallrash të Rrezikshme.
- Komisioni Vlerësimit të Ofertave konstaton se Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Alb-Shpresa” shpk & ”Mela” shpk nuk përmbushin pikën 15, gërma “b”: *“Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) b)leje qarkullimi; c)çertifikatën e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)çertifikatën për transport mallrash brenda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a)dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi; c)çertifikatën e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brenda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore te blerjes”,* pasi operatori ekonomik “Mela” shpk ka deklaruar mjetin “Autobetoniere Matalgante” për të cilën ka paraqitur vetëm faturë tatimore dhe zhdoganimi; si dhe operatori ekonomik “Alb-Shpresa” ka deklaruar mjetin autobetoniere të marrë me qera nëpërmjet kontratës Nr.373.Rep, Nr.145.KOI për të cilën nuk ka paraqitur Çertifikatën për Transport Mallrash brenda vendit.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatoreve ekonomik “Alb-Shpresa” shpk &”Mela” shpk, referuar Shtojcës 10 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

#### 4. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatoreve ekonomik “Liqeni VII” sha & “Varaku E” shpk

NUIS K01730502W & NUIS J61902509S

- Operatori ekonomik “Varaku E” shpk nuk plotëson pikën 6 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe të figurojnë në listëpagesa, 1 (një) mjek të përgjithshëm. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm” pasi për mjekun e përgjithshëm, Urdhëri i Mjekut, Nr. 27 (leje individuale për për ushtrimin e profesionit për mjekë) rezulton i pavlefshëm. (lëshuar në datë 09.04.2012 dhe leja është e vlefshme për 5 vjet dhe rinovimi bëhet 2 muaj përpara mbarimit të afatit). Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se Operatori ekonomik “Varaku E” shpk nuk ka paraqitur dokumentin e rinovuar.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, konstaton se mjeti Autobitumatriçe, me targë AA365IB i deklaruar nga operatori ekonomik “Liqeni VII” sha rezulton të jetë i angazhuar në kontratën me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Dhimitër Shuteriqi”, për të cilën ky operator është shpallur fitues.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Liqeni VII” sha & “Varaku E” shpk nuk plotëson pikën 15, gërma “b”: *“Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) b)leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a)dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore te blerjes”,* pasi Mjeti kamioncinë me targë DR9043 nuk plotëson tonazhin e kërkuar, kapaciteti mbajtës 1,7 ton.
- KVO konstaton se dokumentacioni për mjetin eskavator me targë AA 531 AA të marrë me qera rezulton fotokopje I pashoqëruar me vërtetimin e njëhësim të kopjes me origjinalin clka bie në kundërshtim me kushtin e përcaktuar në DST: ***“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”***.

#### 5. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatoreve ekonomik “Bean” shpk & “Erges Mat” shpk

NUIS J72510445Q & NUIS K17614913O



- Operatori ekonomik “Erges-Mat” shpk nuk plotëson pikën 1 te Kapacitetit ekonomik dhe financiar të DST-së: “Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2015, 2016, 2017), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar” pasi KVO konstaton mungesën e bilancit për vitin 2017 (është paraqitur vetëm raporti I audituesit të pavarur për vitin 2017).
- Operatori ekonomik “Erges-Mat” shpk nuk plotëson pikën 6 te Kapacitetit teknik të DST-së: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar; të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesa, 1 (një) mjek të përgjithshëm” pasi për mjekun e përgjithshëm nuk është paraqitur kontrata e punës, Diploma dhe Urdhër mjeku.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetin Autobitumatriçe, të deklaruar nga operatori ekonomik “Bean” shpk konstatoi se mjeti rezulton të jete I montuar kamion I certifikuar për transport mallrash brenda vendit + cisterne bitumi, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetin Autobitumatriçe, të deklaruar nga operatori ekonomik “Bean” shpk konstaton se nuk është paraqitur Çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, gërma “b”.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Bean” shpk & “Erges-Mat” shpk nuk përmbushin pikën 15, gërma “b”: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)/ Kamionçina me kapacitet mbajtës 2-5 ton”, pasi asnjë nga kamioncinat nuk plotëson kapacitetin e kërkuar, kamioncina me targë AA859LG 0,92 ton, kamioncina me targë AA382MS 0.8 ton dhe kamioncina me targë AA147SC 0,75 ton.
- Për kamionin me targë AA 511 LU të deklaruar në shtojcën 10 është paraqitur e paplotë leja e qarkullimit cka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, gërma “a”.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetin Autobot Uji, të deklaruar nga operatori ekonomik “Bean” shpk konstatoi se mjeti rezulton të jete I montuar kamion I certifikuar për transport mallrash brenda vendit + bot, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetet Eskavator, të deklaruar nga operatori ekonomik BOE konstatoi se për eskavatorët goma me targë TR7182F dhe ABMT 66 nuk janë paraqitur foto, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, gërma “d”.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Bean” sh.a & “Erges-Mat” shpk,

referuar Shtojcës 10 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

## 6. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Curri” shpk NUIS J67902718S

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për stafin teknik, konstatoi se shoqëria “Curri” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se ka të punësuar 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili transport), çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Shoqëria “Curri” shpk ka deklaruar si drejtues teknik te shoqërisë Ing. Z. B.D te cilin me ane te deklarates per drejtuesin teknik e ka caktuar tashme drejtues teknik per objektin ne te cilin eshte kualifikuar ne vend te pare nga Bashkia Tirane: “Rikonstruksion i Infrastrukturës rrugore të bllokut të kufizuar nga rrugët ”Zogu i I-rë” – rruga ”Dibrës” – ”Siri Kodra” dhe ”Reshit Petrela” dhe per te cilin ka deklaruar se nuk do te jete i angazhuar ne kontrata te tjera dhe do te jete gjate gjithë kohes ne objekt duke mos plotësuar kështu Kriteret e Veçanta per Kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 3, pjesë përbërëse e Dokumentave Standarte të Tenderit.
- Shoqëria “Curri” shpk ka deklaruar si Ing. Topograf Z. D.F. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues per Ing. e sipërcituar konstatoi se Operatori ekonomik nuk ka paraqitur librezën e punës, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik “Curri” shpk ka deklaruar se disponon 3 (tre) kamionçina përkatësisht me targa AA 653 HA; AA 395 OS si dhe AA 179 OL. Pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetet e deklaruara si më lart, KVO konstatoi se kamionçina me targë AA 653 HA ka kapacitet mbajtës 1.2 Ton; mjeti me targë AA 395 OS ka kapacitet mbajtës 0.9 Ton ndërsa mjeti me targë AA 179 OL ka kapacitet mbajtës 1.3 Ton. Për sa më lart, Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 3 (tre) kamionçina me kapacitet mbajtës 2 – 5 ton”*.
- Gjithashtu referuar Shtojcës 10, Shoqëria “Curri” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobitumatriçe. KVO pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues konstatoi se mjeti i sipërcituar rezulton të jetë Autobitumatriçe e montuar = Kamion + cisternë termike, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Autobitumatriçe”*.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Curri” shpk, referuar Shtojcës 10 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

## 7. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Arifaj” shpk

NUIS J76418907K

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqëruar për stafin teknik, konstatoi se Inxhinieri i Mjedisit nuk është i pajisur me Çertifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- KVO konstatoi se Operatori ekonomik “Arifaj” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se ka të punësuar 2 (dy) punonjës bojaxhinj, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7.

Gjithashtu Operatori ekonomik “Arifaj” shpk ka paraqitur dokumentacion vetëm për 1 (një) punonjës teknik ndërtimi, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7 ku përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë:*

- *2 (dy) punonjës teknik ndërtimi*
  - *3 (tre) punonjës hidraulik*
  - *1 (një) punonjës karpentir*
  - *2 (dy) punonjës elektrikistë*
  - *2 (dy) punonjës saldatorë*
  - *2 (dy) punonjës bojaxhinj*
- *Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; deshmite e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.”*
  - Në këtë mënyrë shoqëria nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 4, çka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të Nenit 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” (i ndryshua) ku përcaktohet se:
  - *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, **duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....***
  - *b)Aftësia teknike ;Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative,.reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe **personelin e nevojshëm** për të zbatuar kontratën.....*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatorëve ekonomik “Rrugë Sinjalistike Mirëmbajtje dhe Hidro Company” Degë e shoqërisë së huaj & “Egland” shpk**, me adresë: **Tiranë, Njësia Nr. 8,Rruga “Xhorxhi Martini”, Nr. 2, godinë Nr. 11-katëshe, Shkalla 2, kati 7**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **72,119,145** (shtatëdhjetë e dy milion e njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e njëqind e dyzetë e pesë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2,

Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **92,788,168** (nëntëdhjetë e dy milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, siç parashikohet në Nenin 58 pika 5 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar).

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 29.08.2018**

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.

